



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

### KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përgjigje të kërkesës suaj, ku në kuadër të bashkëpunimit me Këshillin Shqiptar të Medias po përgatisni artikuj për promovimin e vetërregullimit të komunitetit të medias, vihen në dispozicion çështjet e trajtuara nga ana e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi drejtuar mediave në Shqipëri.

Gjatë vitit 2023, nga ana e Komisionerit janë shqyrtuar 6 çështje, në të cilat është pretenduar diskriminim nga ana e drejtuesve të emisioneve apo pjesëmarrësve/të ftuarve në to. Aktualisht, KMD ka mbyllur me vendim 3 ankesa dhe vijon procedurën hetimore për 3 ankesa të tjera. Si rezultat i trajtimit të çështjeve të mbyllura Komisioneri ka konstatuar si më poshtë:

- Në 2 (dy) raste nuk është konstatuar diskriminim;
- Në 1 (një) rast është konstatuar diskriminim në formën e gjuhës së urrejtjes nga një i ftuar në emisionin televiziv.

Lidhur me ankesat e mbyllura me vendim, Komisioneri është shprehur me vendim të cilat gjenden në linqet si më poshtë:

- <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/06/Vendim-nr.-59-date-12.04.2023-CRA-kunder-Big-Brother-Vip-Top-Channel-Mosdiskriminim.pdf>
- <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/09/Vendim-nr.-149-date-31.07.2023-E.-M.-kunder-Syri-Tv-Mosdiskriminim.pdf>
- <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2023/10/Vendim-nr.-199-date-11.10.2023-Shoqata-Per-Drejtesi-Sociale-k.-S.-N-dhe-Top-Channel-Diskriminim-gjuhe-urrejtje.pdf>

Sa i përket ankesave për të cilat vijon procedura e shqyrtimit, objekti i tyre ka të bëjë me sa më poshtë vijon:

1. Shoqata “Vish këpucët e mia”, kundër Emisionit Xhadat, në MCN TV, pretendim diskriminim për shkak të Etnisë. Në ankesë pretendohet se: “Në datën 11 Tetor, ora 16:22, në rrjetin social me titull "Xhadat", është transmetuar pjesë nga emisioni "Xhadat", MCN TV, ku ndër të tjera përdoret gjuha e urrejtjes ndaj Komunitetit Rom në Shqipëri. Në këtë emision një nga folëset (gazetaret humoriste), ndër të tjera ka thënë "...e ka bërë me beton, se po ta bënte hekur vinin kurbeterit dhe ja shisnin", termi kurbeterit është një term diskriminues dhe denigrues për komunitetin Rom i përdorur në qytetin e Korçës, gjithashtu konteksti i kësaj video tregon etiketime diskriminuese për këtë minoritet. Kjo video vazhdon të jetë në rrjetin social Facebook dhe MCN. TV, website.

2. Subjekti A. F., kundër Emisionit Stop, Klan Tv, pretendohet diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, në ankesë pretendohet se: “Në datën 28.09.2023 një person që në fakt ishte i infiltruar nga Emisioni “STOP”, ka telefonuar ankuesin i cili i ka kërkuar të plugojë tokën. Në videon që ka bërë publike emisioni është prerë dhe është përdorur vetëm fraza ku pohon “pa merak se do ta punoj unë tokën”. Por në të vërtetë është djali që punon me zetar. Pretendon se disponon edhe kamerat ku gazetari i emisionit hynë në shtëpinë time dhe disponon po ashtu video ku më pas i kam kaluar djalin për të biseduar për vazhdimësinë e punës. Emisioni është shfaqur në datën 02.10.2023. Sipas KMCAP ankuesi fiton të ardhura për invaliditet të plotë nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2024. Gjithashtu me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë sipas Ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, i ndryshuar, është përfitues si grupi II-të (invalid pune) nga data 15.05.2023 deri me datë 15.05.2028”.

3. Qendra për Aksion Komunitar, kundër Emisionit Top Story, Top Channel, pretendohet diskriminim për shkak të racës dhe etnisë, në ankesë pretendohet se gjatë emisionit nga i ftuari A.T e më pas nga prezantuesja e emisionit G.D, është përdorur dhe folur në terma pezhorativ dhe denigrues si “Jevgjitkat e Shqipërisë”.